



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT
të mbledhjes së dhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të
Komunës së Prishtinës, mbajtur më 23.10.2012, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Engin Beyoglu, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti,
Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Mungoi Sami Hamiti.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Engin Beyoglu, zëvendëskryesues.

Njëzëri u miratua ky

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë;
2. Informatë për suksesin e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm për vitin 2011/12;
3. Informatë për shpenzimet dhe të hyrat për periudhën janar-shtator 2012;
4. Propozimvendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
5. Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim;
6. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve në shumë prej 100.000,00 €, si ndihmë për punëtorët e organeve të administratës, të institucioneve kulturore dhe qendrave për punë sociale të Komunës së Prishtinës;
7. Të ndryshme.

Pika e parë

Hazir Borovci bëri vërejtje në ekstrakt, në pikën e katërt, duke cekur se propozimit të dhënë që ka të bëjë me marrjen e masave për parandalimin e rrëshqitjes së dheut, t'i shtohet " ... te gjimnazi "Xhevdet Doda"".

Me vërejtjen e dhënë, njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së nëntë.

Pika e dytë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Halim Halimi**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit. Ai tha se në bazë të raporteve të paraqitura nga shkollat e arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe atij të mesëm i lartë, kemi hartuar këtë informatë për suksesin e nxënësve.

Shemsi Veseli tha se në kuadër të kësaj informate është dashtë të paraqiten edhe sfidat, të cekën se cilat janë objektivat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, andaj sugjeroj që këto të jenë pjesë e kësaj informate.

Për disa çështje që paraqesin pengesë në mbarëvajtjen e mësimin, në veçanti problemet shëndetësore, propozoi që të nxirret një vendim, konkluzë nga Kuvendi i Komunës dhe t'i bëhet kërkesë nivelit qendror që të bëjë rregullimin e këtyre çështjeve.

Shefqet Sylejmani e përkrahu informatën, por propozoi që para se të dërgohet për shqyrtim në Kuvend, materiali të jetë teknikisht më i lexueshëm.

Në këtë informatë është dashtë që, së paku me një fjali, të thuhet se duhet të përmirësohen ato dobësi, dhe të bëhen përpjekje për tejkalimin e tyre. Nuk është mirë që në konturat e këtij materiali të jepet struktura e nxënësve.

Ai i propozoi Drejtorisë së Arsimit, që t'ua mundësojë një vizitë në shkollën "Model", te ish-Tjegullorja, që është në ndërtim e sipër.

Mustafë Krasniqi tha se kjo është një informatë e përgatitur mirë, por është pak shqetësuese rënia e notës mesatare. Duhet shihet se çka ka ndikuar që kjo ka shkau në rritje, prej kl. 10 - 13.

Hazir Borovci i përkrahu të gjithë parafolësit dhe propozoi që, në nivel të komunës së Prishtinës, të analizohet çështja e mundësisë për dhënien e bursave nxënësve talentë.

Lidhur me disa vërejtje dhe sugjerimet të dhëna, **Halim Halimi** dha sqarime të nevojshme.

U konstatua se njëzëri u përkrah Informata për suksesin e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm për vitin 2011/12 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tretë

Përkitazi me këtë pikë të rendit të ditës informoi Xhelil Bekteshi. Ai tha se në këtë informatë në mënyrë tabelore kemi paraqitur të hyrat vetanake dhe shpenzimet buxhetore për periudhën janar - shtator 2012.

Tefik Mehmeti tha se kjo është një informatë e nevojshme, e cila na jep një pasqyrë për qarkullimin e parasë. Sipas shënimeve tabelore shihet se të hyrat janë të planifikuara, pra është një rezultat i mirë se janë në kuota të planifikimit. Gjithashtu edhe shpenzimet buxhetore janë në trend pozitiv.

Shemsi Veseli tha se është një raport i mirë, por duhet të jetë një transparencë më e madhe për kahjen e buxhetit, gjithashtu është dashtë të analizohet edhe dinamika e projekteve. Vërehet se të hyrat vetanake janë pozitive në disa fusha, si dhe të hyrat nga tatimi në pronë.

Pak brengosëse janë shpenzimet buxhetore te investimet kapitale, pasi që është një ritëm i ngadaltë, andaj dhe është frikë se paratë mund të shkojnë në suficit. Mendoj se minimumi i shpenzimit të buxhetit është dashtë të jetë 60%.

Aziz Pacolli kërkoi që shpenzimet buxhetore të zërthehen më tepër, pra të dihet se ku dhe për çka janë harxhuar ato mjete.

Shefqet Sylejmani tha se kjo informatë është përgatitur mirë, andaj dhe i bashkohem disa sugjerimeve të dhëna nga parafolësit. Vërejtje pati në disa fusha, dhe sugjeroi që, në të ardhmen, me rastin e planifikimit të projekteve, këto të jenë minimale. Sugjeroi që Drejtoria e Inspekcioni të jetë më përgjegjëse në kuadër të detyrave që ka. Sa i përket shpenzimeve, ato janë normale në kuadër të planifikimit. Për të qenë sa më të realizueshme projektet, kërkoi që të thjeshtësohen disa procedura të prokurimit.

U shpreh në përkrahje të informatës, bashkë me sugjerimet e dhëna.

Lidhur me disa vërejtje dhe sugjerime që u paraqitën nga parafolësit, **Xhelil Bekteshi** dha sqarime shtesë.

U konstatua se njëzëri u përkrah Informata për shpenzimet dhe të hyrat për periudhën janar-shtator 2012 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e katërt

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Agim Salihu tha se në bazë të Ligjit për policinë dhe të Udhëzimit administrativ për këshillat komunalë, është paraparë që kuvendet komunale t'i themelojnë këta këshilla.

Aziz Pacolli shtroj pyetjen se a ka ndonjë dallim në mes këshillit të mëhershëm dhe të tanishmit, cilët ishin dhe kush e përbëjnë tani këtë këshill.

Shefqet Sylejmani shtoi se ky këshill ka qenë edhe më herët dhe ka punuar me sukses. Kërkoi të dijë se a e ka përkufizuar ligji numrin përfundimtar të përbërjes së tij. Gjithashtu kërkoi që nenit tre t'i jepet forma më ligjore, pasi që kompetencat e cekura, ashtu siç janë, nuk qëndrojnë.

Tefik Mehmeti bëri vërejtje rreth përbërjes, duke pyetur se pse nuk e kemi ndonjë anëtar të KPF-së apo të Kuvendit në përbërje të këtij këshilli.

Shemsi Veseli tha se është një s'përputhje me Kuvendin e Komunës, pasi që në këtë përbërje të këtij Këshilli nuk është përfshirë asnjëri nga anëtarët e KPF-së apo të Kuvendit. Kërkoi që të bëhet një rekomandim për organet përkatëse.

Për pyetjet e parashtruar dhe vërejtje e dhëna, **Agim Salihu** dha sqarime të nevojshme.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e pestë

Lidhur me Propozimvendimin për vazhdimin e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, Agim Salihu tha se është propozim që disa subjekteve afariste t'iu vazhdohet afati i shfrytëzimit të pronës komunale edhe për tri vite.

Mustafë Krasniqi kërkoi nga të gjitha drejtoritë që të kujdesen për këto vendime. Duhet ditur se ata pronarë a janë shfrytëzues, apo ato prona kanë kaluar tek pala e dytë apo e tretë në shfrytëzim dhe a janë pagues të rregullt të qirasë. Të mos merret asnjë vendim për vazhdimin e kontratave derisa të dëshmohet se i kanë krye të gjitha obligimet ndaj Komunës.

Në parim e përkrahim këtë propozimvendim, në mënyrë që në mbledhjen e Kuvendit të kemi informata plotësuese.

Aziz Pacolli kërkoi të dijë se sa është çmimi për shfrytëzimin e këtyre pronave. Gjithashtu kërkoi informata më të plota se a ka ndonjë parcelë që i ka kaluar afati i shfrytëzimit dhe ajo shfrytëzohet nga ndonjë pronar, e që ne për këtë nuk jemi në dijeni.

Shemsi Veseli tha se do të ishte më se e domosdoshme që ta kemi një informatë të saktë për ata pronarë, se brenda këtyre tri viteve a iu kanë përmbajtur marrëveshjes së arritur apo e kanë kaluar në personin e tretë. Kërkoi që për mbledhjen e radhës së Kuvendit, të jetë një informatë se ata shfrytëzues të pronave a kanë paguar qiranë apo jo, pra ta kemi një pasqyrë të qartë me emër e mbiemër të pronarëve dhe të kompanive.

Shefqet Sylejmani fillimisht kërkoi të dijë se a janë përfitues legjitim këta shfrytëzues. Ai njëherësh kërkoi përgjigje në këto pyetje:

- A janë shfrytëzues të drejtpërdrejtë apo qiradhënës?
- A ka përkufizim kohor, apo është një mandat?
- A janë të evidencuara të gjitha parcelat, apo ka ndonjë që se kemi në evidencë të pronës komunale ?
- A jemi duke i përcjellë të gjitha këto parcela që janë në shfrytëzim, pra prej fillimit të mandatit të parë e tutje?

Xhelil Bekteshi tha se pronarëve të cilët janë propozuar për t'iu vazhduar afati i shfrytëzimit të pronave, iu ka vazhduar afati prej vitit 2009 dhe janë pagues të rregullt të qirasë.

Kryesuesi tha se duke pasur për bazë të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet, këtë propozimvendim do ta dërgojmë për shqyrtim në Kuvend, ku me informata shtesë do të informohemi më hollësisht rreth shfrytëzimit të këtyre pronave komunale.

Lidhur me disa vërejtje she sugjerime që u dhanë nga parafolësit, sqarime shtesë dha **Agim Salihu**.

Duke marrë për bazë kryesisht kërkesën e z. Veseli dhe Sylejmani, që për mbledhjen e Kuvendit të sillen informata plotësuese rreth shfrytëzimit të këtyre pronave, u konstatua se u përkrah njëzëri Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimvendimin për lejimin e mjeteve në shumë prej 100.000,00 €, si ndihmë për punëtorët e organeve të administratës, të institucioneve kulturore dhe të qendrave për punë sociale të Komunës së Prishtinës, Xhelil Bekteshi tha se kjo është bërë në bazë të kërkesës së Sindikatës së Komunës, që për festat e fundvitit të merret një qëndrim për ndihmë financiare për këta punonjës.

Tefik Mehmeti propozoi që në këtë propozimvendim, me një nen të veçantë, të ceket se *ndarja e mjeteve bëhet në mënyrë lineare.*

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për lejimin e mjeteve në shumë prej 100.000,00 €, si ndihmë për punëtorët e organeve të administratës, të institucioneve kulturore dhe të qendrave për punë sociale të Komunës së Prishtinës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e shtatë

Të ndryshme

Xhelil Bekteshi i informoi të pranishmit se Ministria e Financave ka kërkuar që të bëjë një rritje të mjeteve në fondin e pagave, konkretisht për Drejtorinë e Arsimit, pra duhet të bëhen zbritje në programet tjera. Janë marrë mjete nga disa projekte të rrugëve dhe kanë shkua në paga për punëtorët e Drejtorisë së Arsimit.

Shefqet Sylejmani përgëzoi për kryerjen e disa punëve të mira që janë bërë në objektin e Komunës.

Mbledhja mbaroi në orën 17:00.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Zv. kryesuesi i Kuvendit për Komunitete
Engin Bejoglu**